




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>20/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-4852/14</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>17-12-2014</u>
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 4258/14, për z. Avni Murati – Zyrtar i Auditimit të Brendshëm – NP Infrakos Sh.A., për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-4258/14, për z. Avni Murati – Zyrtar i Auditimit të Brendshëm – NP Infrakos Sh.A., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Murati, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Ndërmarrjen Publike Infrakos Sh.A. dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat N.P. “Kont-Ek”.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Murati është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat, dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për ti bërë ndryshimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 4642/14) me të cilën vërtetohet se në biznesin privat N.P. "KONT-EK" ka emëruar një person të besueshëm si person të autorizuar. Me këtë z. Murati ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

